

**V E N D I M**  
**Nr.125, datë 13.3.1995**

**PËR FINANCIMIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR MASAT PARANDALUESE E  
MJEKUESE NDAJ SËMUNDJEVE NGJITËSE**

Në bazë të ligjit nr.7761, datë 19.10.1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse” (neni 10), me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

1. Të përfitojnë medikamente falas për mjekimin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse:
    - 1a) të sëmurët me sëmundjet e konventës (kolerë, murtajë, ethe të verdha), malarje, sifiliz, lepra dhe SIDA (AIDS), dermatofiti endemike, gonore dhe zgjebe, si dhe bartësit e tifos së zorrëve si kur mjekohen në kushte ambulatorie, ashtu edhe kur vazhdojnë ciklin e mjekimit pas daljes nga spitali;
    - 1b) personat e “kontaktit të ngushtë”, sipas përcaktimit të bërë prej Shërbimit Epidemiologjik, me të sëmurët me:
      1. kolerë.
      2. murtajë.
      3. meningjit epidemik (vetëm për rastet në çerdhe, kopshte e konvikte).
      4. personat që kanë rënë në kontakt me kafshë të sëmura me plasje;
    - 1c) personat vendas që kanë qarkulluar në vende malarike (kimioprofilaksi).Skemat e mjekimit dhe lloji i medikamenteve përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit për secilën sëmundje.
  2. Të përfitojnë vaksinimin falas:
    - a) personat që i nënshtrohen vaksinimit të detyrueshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
    - b) Personat që i nënshtrohen vaksinimit me indikacion epidemiologjik.
  3. Të përfitojnë analiza laboratorike falas me qëllim diagnostikimi dhe kontrolli personat:
    - a) që dyshohen për sëmundje ngjitëse, si dhe ata që kanë kontakt të ngushtë me të sëmurë me sëmundje ngjitëse;
    - b) që kanë rezultuar bartës të sëmundjeve ngjitëse (rikontroll);
    - c) që u nënshtrohen analizave laboratorike me qëllim kontrolli profilaktik dhe studimi.Kriteret për kryerjen e ekzaminimeve laboratorike në kontigjentet që përfshihen në pikën 3, përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.
  4. Të kryhen falas trajtimet me preparatet dezinfektante, dezinfektante dhe deratizuese në vatrat e infeksionit, të përcaktuara nga Shërbimi Epidemiologjik.
  5. Drejtoritë e shëndetit publik të rretheve, QSUT, Instituti Kërkimor i Higjienë - Epidemiologjisë dhe Drejtoria e Higjienës dhe Epidemiologjisë në Tiranë të sigurojnë rezervën e domosdoshme të preparateve D.D.D. dhe të materialeve e medikamenteve të tjera të nevojshme për parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve ngjitëse në përgjithësi dhe në veçanti për sëmundjet që përcaktohen në këtë vendim.
  6. Fondet për shpenzimet e barnave, preparateve imunobiologjike, reagentëve dhe të lëndëve D.D.D., sipas nevojave, të përballohen nga institucionet shëndetësore brenda buxhetit të shëndetësisë.
  7. Shpërndarja e barnave për qëllime mjekuese e parandaluese për të sëmurët, bartësit ose personat e kontaktit me sëmundje ngjitëse, të përfshira në këtë vendim, të bëhet nëpërmjet rrjetit farmaceutik me recetë falas tip, lëshuar nga mjekët specialistë të dispenserëve të sëmundjeve ngjitëse. Barnat për personat që përfshihen në pikat 1b dhe 1c, të shpërndahen nga shërbimet epidemiologjike të rretheve, sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**